

Guvernatori z. Bedri Hamza mbajti fjalim rasti në Konferencën "Të ndërtohet ura drejt një ardhmërie të begatshme" të organizuar nga Banka Botërore në Kosovë

Prishtinë, dhjetor 2015

I nderuari Ministër Hoti,

E nderuara zj Goldstein,

Të nderuar kryetarë të komunave zj.Kusari-Lila dhe z. Ahmeti,

I nderuari z. Olters,

Të nderuar përfaqësues të institucioneve të Kosovës, akademisë dhe institucioneve ndërkombëtare,

Mysafirë të nderuar,

Kam kënaqësinë e veçantë të mbaj këtë fjalim rasti dhe sinqerisht falënderoj z. Olters për organizimin e këtij forumi të formatit përshëndetës por me një përmbajtje të rëndësishme së veçantë për Kosovën – atë të zhvillimit ekonomik.

Në mjedisin e sotëm, kur agjendat zhvillimore ballafaqohen me sfidat e vazhdueshme të krizave financiare dhe atyre socio-ekonomike, çështja e perspektivës ekonomike zë rol kyç në agjendën e shteteve globalisht. Aq më tepër kur flasim për vendet e Evropës Juglindore dhe modelin zhvillimor të këtyre vendeve bazuar në frymën e integritit evropian me qëllim fundamental të zhvillimit ekonomik përmes rritjes ekonomike, krijimit të vendeve të punës, ndërtimit të infrastrukturës vitale dhe zhvillimit të qëndrueshëm për regjionin dhe Kosovën.

Më lejoni që të ndaj me ju disa pikëpamje lidhur me mundësitë dhe sfidat, që regjioni dhe Kosova ka në këtë drejtim. Kosova është shtet potencial anëtar i BE-së me një ekonomi të vogël, por shumë dinamike dhe me qasje të privilegjuar në *Tregun e Përbashkët të Evropës* me mbi 500 milionë konsumatorë.

Kosova së bashku me regjionin janë në rrugëtim drejt finalizimit të tranzicionit për funksionalizim të ekonomisë së tregut të lirë deri në përfundim të integritit të plotë në Bashkimin Evropian. Marrëveshja e Stabilizim Associmit e nënshkruar këtë vit do jetë udhërrëfyes i fuqishëm për Kosovën në këtë proces. Agjenda e reformave përkatëse është komplekse dhe kërkon kohë, por janë ndërmarrë hapa të rëndësishëm për t'i shndërruar pengesat kryesore në alternativa dhe mundësi të zhvillimit ekonomik. Kosova dëshmoi rezistencë, dhe si rezultat është rritur dhe zhvilluar çdo vit duke përballuar kështu edhe efektet nga kriza financiare globale dhe ajo e Eurozonës. Veprimet e ndërmarra në vitet e fundit për politikat zhvillimore i kanë dhënë Kosovës një themel të fortë, mbi bazën e së cilit vendi mund të zhvillojë shërbime dhe produkte, që janë konkurruese jo vetëm në nivel lokal por edhe në Tregun e Përbashkët të Evropës. Për vendin tonë, qasja e privilegjuar të konsumatorët evropianë është një përfitim i madh për kompanitë që operojnë në Kosovë, duke përfaqësuar një potencial të rëndësishëm për të zhvilluar një sektor privat të orientuar nga eksporte. Ne duhet të jemi të vetëdijshëm dhe të përfitojmë plotësisht nga kjo mundësi. Këto tregje janë në vendet me të ardhura me fuqi të konsiderueshme blerëse dhe në vendet që janë duke u zhvilluar. Sidomos në Evropën Qendrore dhe Veriore, aktualisht vendet me dinamikë në BE, ekziston një prani e fuqishme e diasporës së Kosovës dhe mundësi unike për të hapur dyert e këtyre tregjeve atraktive. Pengesë për mallrat dhe shërbimet "e bëra në Kosovë" nuk është qasja në tregje por sfidat e mbetura të procesit të tranzicionit drejt një ekonomie funksionale të tregut, këtu me theks të veçantë do të përmendja kërkesat për standardet e cilësisë që mallrat dhe shërbimet e Kosovës, duhet t'i plotësojnë për të qenë konkurruese në tregjet jashtë Kosovës.

Në kohë, rëndësia e pozicionit gjeografik është duke u ulur, përderisa faktorët që po bëhen më të rëndësishëm në kontekst të vendimeve që investitorët marrin në konsideratë për zhvillimin e aktivitetit të tyre ekonomik përfshijnë:

- Mjedisin e qëndrueshëm politiko-ekonomik, duke përfshirë energjinë që është e sigurt, e përballueshme dhe e pastër;
- Sistemin e shëndoshë financiar;
- Fuqinë punëtore të kualifikuar, dhe
- Sistemin efektiv ligjor;

Kontributi i BQK-së për të krijuar një ambient të mirë për investime në Kosovë përfshin promovimin dhe mbajtjen e një sistemi financiar, në veçanti sistem bankar të shëndoshë dhe të

qëndrueshëm përmes mbikëqyrjes efektive dhe të bazuar në standardet më të larta ndërkombëtare. Sektori financiar vazhdon të mbetet një nga sektorët që ka nivelin më të lartë të investimeve të huaja direkte.

Roli i sistemit financiar në mbështetje të zhvillimit ekonomik të vendit ka vazhduar të rritet dhe atë kryesisht në saje të zhvillimeve në kuadër të aktivitetit të sektorit bankar. Kreditimi i sektorit bankar ka shënuar rritje të dukshme, duke ngritur nivelin e kreditimit në mbi 2 miliardë euro, me normë vjetore të rritjes prej 8.2 përqind, përderisa në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar kreditë kishin shënuar një normë vjetore të rritjes prej vetëm 3.1 përqind. Kategoria që i kontribuoi më së shumti rritjes së gjithsej kredive ishte kategoria e kredive për ndërmarrjet, që shënoi një rritje vjetore prej 5.9 përqind. Vlen të theksohet, se në kuadër të kredive për ndërmarrjet, rritjen më të lartë e shënuan sektorët që kanë pjesëmarrje më të ulët në gjithsej kreditë e sektorit bankar, çka tregon se bankat kanë filluar të mendojnë më tepër për nevojën e diversifikimit të portofoleve të tyre dhe për përkrahje më të madhe për sektorët, që kanë rëndësi të madhe për zhvillimin ekonomik të vendit. Më konkretisht, sektorët që shënuan rritjen më të lartë të kredive të pranuar ishin sektori i prodhimit me rritje vjetore prej 16.7 përqind dhe sektori i bujqësisë me rritje prej 11.8 përqind në tetor 2015.

Rritja e kreditimit për këta sektorë pa dyshim se paraqet zhvillim të rëndësishëm për ekonominë, duke pasur parasysh potencialin që kanë këta sektorë për të rritur prodhimin vendor dhe në këtë mënyrë, të ndikojnë drejtpërsëdrejti në adresimin e dy sfidave kryesore të ekonomisë së Kosovës, që janë shkalla e lartë e papunësisë dhe deficitin e lartë tregtar. Financimi bankar për këta sektorë pritet të rritet edhe më tutje pas themelimit të Fondit Kosovar për Garanci Kreditorë, i cili paraqet një zhvillim shumë të rëndësishëm si për bizneset përfituese të garancisë kreditorë, ashtu edhe për bankat të cilat do të ballafaqohen me nivel më të ulët të humbjeve të mundshme që mund të rezultojnë nga rreziku kreditor.

Përveç faktit se kemi përshpejtim të ritmit të kreditimit, është me rëndësi edhe fakti se pjesa më e madhe e kredive të reja të lëshuara në periudhën janar-tetor 2015 është lëshuar për qëllime investive të ndërmarrjeve. Në kuadër të gjithsej kredive të reja të lëshuara për ndërmarrjet gjatë kësaj periudhe, kreditë investive kishin një pjesëmarrje prej 64.3 përqind.

Me rritjen e vazhdueshme të konkurrencës në tregun bankar, si dhe rritjes së pjekurisë së këtij sektori, kostoja dhe kushtet e financimit bankar gjithashtu kanë vazhduar të shënojnë rënie,

respektivisht përmirësim. Norma mesatare e interesit në kredi në tetor 2015 ishte 8.2 përqind, krahasuar me normën prej 10.4 përqind në tetor 2014 dhe 11.4 përqind në tetor 2013. Ky nivel i normave të interesit tani më e ka bërë koston e financimit bankar në Kosovë të jetë në nivel të përafërt me koston e financimit në vendet e tjera të rajonit, duke paraqitur kështu përmirësim të rëndësishëm në njërin prej fushave që në vazhdimësi është raportuar nga bizneset si pengesë për zhvillimin e afarizimit të tyre. Në kuadër të kredive për ndërmarrjet, në veçanti vlen të potencohet zvogëlimi i theksuar i normës së interesit për kreditë bujqësore, që në tetor 2015 kishin një mesatare prej 9.0 përqind, përderisa rreth dy vite më parë norma mesatare e interesit në këto kredi ishte rreth 20 përqind.

Niveli i përgjithshëm i qëndrueshmërisë së sektorit bankar vazhdon të jetë i lartë, bazuar në të gjithë treguesit e shëndetit financiar. Pozicioni i likuiditetit dhe kapitalizimit ka shënuar rritje të mëtejme dhe janë dukshëm mbi nivelin e kërkuar nga Banka Qendrore. Gjendja e kënaqshme e stabilitetit të sektorit bankar pasqyrohet edhe nga cilësia e mirë e portofolit kreditor. Niveli edhe ashtu i ulët i kredive joperformuese shënoi rënie të mëtejme, duke rënë në 6.8 përqind në tetor 2015 nga 8.7 përqind sa ishte në tetor 2014. Kjo normë e kredive joperformuese paraqet nivelin më të ulët të regjistruar që nga qershori i vitit 2012 dhe vazhdon ta mbajë Kosovën si vendin me normën më të ulët të kredive joperformuese në rajon.

BQK-ja të do vazhdojë të sigurojë stabilitetin financiar që tani e gëzon. Roli i bankave në veçanti por edhe i institucioneve të tjera financiare në përgjithësi është shumë i rëndësishëm dhe ka ende mjaft hapësirë, që ky rol të avancojë edhe më tutje në mënyrë që ndikimi i tij për zhvillimin e ekonomisë së Kosovës dhe për zhvillimin e mëtejme të vet sistemit bankar të jetë edhe më i madh. Kur them avancimin e rolit të sistemit bankar, kam parasysh proaktivitetin e bankave në tri drejtime kryesore:

- Përmirësim të vlerësimit rreth rrezikut (shpesh të perceptuar) në ekonominë e Kosovës në mënyrë që strategjinë investive ta përshtatin me rrethanat e ekonomisë së Kosovës.
- Orientim të strategjisë së tyre investive drejt sektorëve më pak të kredituar në ekonominë e Kosovës, dhe
- Rritje të mëtejme të efikasitetit në sistemin bankar në mënyrë që kostoja e financimit të vazhdojë me trendin e rënies.

Krijimi i kushteve për rritje të efikasitetit të sistemit bankar paraqet një prioritet të rëndësishëm të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, e cila në vazhdimësi është angazhuar për përmirësimin e infrastrukturës së nevojshme që kjo të arrihet. Mbi të gjitha, vlerësoj se për të bërë një mjedis atraktiv për tërheqje të investimeve të huaja (të nevojshme për të përmirësuar produktivitetin e sektorëve kyç të ekonomisë), së pari duhet ta krijojmë një të tillë për ndërmarrësit dhe investimet vendore. Për adresimin e çështjeve që i ngrita më lart natyrisht që, përveç Bankës Qendrore dhe bankave komerciale, kërkohet një angazhim gjithëpërfshirës i të gjithë akterëve në ekonominë e vendit, në mënyrë që të ballafaqojmë pikëpamjet dhe të gjejmë mënyrën më të mirë, se si sektori financiar dhe sistemi bankar të vazhdojë të zhvillohet edhe më tutje dhe të jetë në funksion edhe më të madh të zhvillimit ekonomik të vendit.

Përfundimisht, ne duhet të vazhdojmë që të gjitha përpjekjet tona të jenë të përqendruara në këtë drejtim në mënyrë që të pozicionojmë Kosovën, në nivel konkurrues në tregjet regjionale dhe evropiane. Në momentin kur ne kemi arritur këtë nivel, atëherë Kosova do të ketë arritur të prezantojë ekonominë e saj në një cikël të rritjes së produktivitetit dhe rritjes së përshpejtuar ekonomike.

Këtu mund të arrijmë, vetëm me një bashkëpunim dhe përkrahje të vazhdueshme të të gjithë partnerëve dhe miqve të Kosovës, njeri prej të cilëve sot është nikoqir i këtij forumi. z. Olters me të cilin këto katër vitet e fundit kemi zhvilluar, ndarë dhe debatuar shumë çështje të interesit të përbashkët. Jam i bindur që rrugët tona të bashkëpunimit do të kryqëzohen edhe në të ardhmen, por ajo që sinqerisht më duhet ta shpreh sot është respekti për punën e palodhshme dhe admirimi për qasjen gjithëpërfshirës ndërinstitucionale, që z.Olters gjithmonë ka reflektuar për adresimin e çështjeve të interesit të përbashkët për vendin. Zoti Olters duke konsideruar këto që thash më lartë dëshiroj t'ju uroj suksese të mëtutjeshme në rrugëtimin tuaj profesional dhe personal.

Ju faleminderit!